

## KARTE TEKNOLOGJIKE PER PLEHRIMIN E QERSHISE

Qershia është një bimë mjaft kërkuese përsa i takon plehrimit mineral.

Veçanërisht këshillohet që azoti të hidhet pjesë-pjesë dhe një sasi të lihet për pas vjeljes së frutit.

Plehërimi organik, fosforo-potasik-azotik janë analogë me plehrimet e drurfrutorëve të tjerë.

Plehrimi i tokës tek qershia fillon me plehrimin organik dhe atë fosfo-potasik, sikurse te gjithë drurfrutorët e tjerë.

### **Azoti**

Si për gjithë drurfrutorët rregullon raportet në mes masës vegetative dhe asaj prodhuese, por në qershinë e shartuar mbi nënshartesë vegetative nevojat për këtë elemente janë më të medha prandaj për këtë qëllim duhet planifikuar që në fillim sasi më e madhe plehu kimik gjithmonë në rast se nuk kemi indikacione negative mbi cilësinë e prodhimit,

### **Fosfori**

Konsumi i fosfotit në qershia nuk është shumë i lartë dhe sillet në masën 15-25 kg/ha kur është në sasira të larta në tokë dhe i plotëson nevojat e parashikuara të prodhimit.

### **Kaliumi**

Potasi (ose kaliumi) në qershia infkuencon në përmbajtjen e sheqerit në frut, turgorin e frutit, peshën dhe veçoritë e ndryshme cilësore të tij. Kërkesa e bimës së qershisë për fosfor në terrene të pasura me hekur aktiv sjell fenomenin e klorozës e cila manifestohet më me ato simptoma sikurse në rastet e terreneve gëlqerore

### **Mikroelementet**

**Të tjerë element të rëndësishëm në qershia** janë kaliumi, magnezi, hekuri, bori, molibdeni, etj. Për të provuar ekzistencën kimike të qershisë për element ushqimor mbështetemi në analizën kimike të tokës e cila bëhet pas marrjes së mostrave në terrenin që do të okupojmë me bimësi. Kjo analize **mund të jetë thjeshtë laboratorike** por mund të jetë **edhe analizë foliore** e cila sjell tregues me real për gjendjen reale të elementëve ushqimor në tokë dhe sasive që duhet të shtojmë përmes plehrimit.

**Analiza** (gjethore) është pak e studjuar tek qershia megjithatë sasite e elementeve ushqimor në lëndën e thatë gjethore në përqindje janë si më poshtë:

N<sub>2</sub>, 2.3 – 2.5 %, P<sub>2</sub>O<sub>5</sub>, 0.3 – 0.4 %, K<sub>2</sub>O, 1.3 – 1.5 %, CaO, 1.7 – 2.2 %, MgO, 0.3 – 0.6 %

### **Plehrimi kimik(suplementar) i qershisë**

Harxhimi i elementeve ushqimor në qershia vlerësohet nga sasia e plehrave kimike të përdorur në menyra manuale dhe të harxhuar nga fruti(prodhim), druri vjetor, kurora

dhe gjethja. Për një prodhim prej 300 kg/ha qershie mendohet se harxhohen këto sasi elementësh ushqimor:

N, 60-100 kg., P<sub>2</sub>O<sub>5</sub>, 15 – 25 kg., K<sub>2</sub>O, 100–120 kg., CaO, 180 – 200 kg.,  
MgO, 20 – 25 kg

Në praktikën bujqësore mund të plehrojmë me sasi të mëposhtme të elementëve në kg/ha për në një pemishte qershie të ekuilibruar dhe në prodhim të plotë.

N, 50- 80 kg., P<sub>2</sub>O<sub>5</sub>, 30 -50 kg., K<sub>2</sub>O, 100 – 120 kg

Në rastet kur terreni është me mungesa të magnezit mund të bëjmë plehrimin me 10-12 kg/ha të MgO.

Megjithatë theksojmë se dozat e plehrave kimike kryesisht varen nga lloji i nënshartesës, faza e frutit, prodhimi për njësi/sipërfaqe, masa e drurit dhe fertiliteti e përmbajtja e lëndës organike dhe elementëve ushqimor të përvetueshëm në tokë.

- Për elementet fosfor e kalium rikujtojmë rëndësinë e plehrit të tyre në plehrimin plotësues, hedhjen e tyre sa më thellë dhe jo shumë afër trungut të bimës dhe mundësinë e mbajtjes së tokës në gjendje të vazhdueshme lagështire.

- Ndërsa plehri organik bëhet direkt me plehra të tillë(organike), të dekompozuar, duke i lokalizuar perreth bimës ose në midis rreshtave, në ëdo 3-4 vjet, dhe jo me pak se 50-60 kg/bimë, duke e futur në tokë përmes punimeve me bel ose traktor.

## Literatura

[1] *Linee guida nazionali per l'agricoltura integrata (2010)*

[2] AA.VV. (1991). *Frutticoltura speciale*. REDA

[3] IASMA Notizie (2007). *Ciliegio*.

[4] Marangoni B., Quartieri M., Scudellari D., (1998). *Gestione del suolo, irrigazione e fertilizzazione del ciliegio*.

*Informatore Agrario n. 27*.

[5] Valli R. (2001). *Arboricoltura generale e speciale*. Edagricole